

22.02 2017 NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, gjyqtari individual Mustaf Tahiri, me sekretaren juridike Drita Ujupi, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II. nr. 1394-2/15, e dt. 19.09.2016, duke vendosur lidhur me kërkesën e prokurorisë për dhënie e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt.09.12.2016 mori këtë:

### AKT GJYKIM

**PRANOHET** kërkesa e PTH-së në Ferizaj, PP/II. nr. 1394-2/15, e dt. 19.09.2016, dhe kjo gjykatë jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, i lindur më dt. [REDAKTUAR] në të njëjtin vend, nga i ati [REDAKTUAR], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal [REDAKTUAR]

### ËSHTË FAJTOR

Sepse më datën, 08.08.2015, rreth orës 16:10, në rrugën "Emin Duraku" në Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës "VW Golf", me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 64/1 të LSKRR-së nga pakujdesia kur ju afrohet kryqëzimit nuk lëviz me kujdes të shtuar për t'ju përshtatur kushteve në komunikacion në kryqëzim me shpejtësi të tillë që të mund të ndalet dhe ti respektoj pjesëmarrësit që kanë përparësi kalimi gjatë kyqjes "Mic Sokoli" në rrugën "Emin Duraku" duke mos u ndalur para shenjës stop, e godet automjetin e markës "Opel Vectra" të cilin e drejtonte [REDAKTUAR] fi, në pjesën e parë të anës së majtë, me të cilin rast pos dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore-ndrydhje në kokë dhe në qafë, pëson e dëmtuara [REDAKTUAR].

**me ç'rast ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPK-së**

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,23,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së

### GJYKON

Me dënim në gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në forma të tjera sipas nenit 46 të KPK-së, i njëjti do të shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do të llogaritet 1 (një) ditë burg.

Të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rr. [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzime të procedurës penale të paguaj shumën prej 110.88 € si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € në afat prej 30 dite nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën, PP/II. nr. 1394-2/15 e dt. 19.09.2016, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] për veprë penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1. të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si, deklarata e të pandehurit në procedurën hetimore të dt.08.08.2015, deklarata e të dëmtuarit [REDAKTUAR] e dt.08.08.2015, mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko-ligjor i datës 21.05.2016, mendimi i ekspertit të komunikacionit i datës 13.03.2016 si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, konstatoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

T dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rr. [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPP-së, obligohet i pandehuri që në emër të shpenzime të procedurës penale në emër të ekspertizës mjeko ligjore dhe ekspertizës së komunikacionit të paguaj shumën prej 110.88 € si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € në afat prej 30 dite nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

## GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.929/16.dt. 09.12.2016

Sekretare Juridike

Drita Ujupi



Gjyqtari

Mustaf Tahiri



**UDHËZIM JURIDIK:** Kudër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhri ndëshkimor merr formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar ekzekutohet.

E. X. P  
9.12.16

